



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.14/2018

Prishtinë, më 7.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Durim Limaj, Rexhep Bllaca dhe Gurakuq Kastrati – MTI; Fjolla Uka – KDI; Amir Kozmaqi – INDEP; Rrahman Ramaj – BIRN; Astrit Panxha dhe Dren Ajeti – KPK; Naim Jakaj-këshilltar i nënkryetares, Berita Abazi, Arta Dehari dhe Marigona Suka, nga grupet parlamentare.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.1.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe;
6. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr. 07/21, datë 22.12.2017, lidhur me Ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike- Pallati i Rinisë – PRN067”;
7. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Mimoza Kusari-Lila, propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës, të radhitet si pikë e tretë e rendit të ditës. Po ashtu, znj. Kusari-Lila propozoi që të shtohet pika e rendit të ditës: “Informim nga z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me zgjedhjen e sekretarit të përhershëm të ministrisë”, si pikë e katërt e rendit të ditës, pasi që sipas informatave që i kemi marrë nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, si mbështetës të projektit për përzgjedhjen e shërbyeseve të lartë civile, na është thënë se procesi është përcjellë me parregullsi.

Kryetarja, theksoi se nuk kemi nevojë të ndryshojmë radhitjen e pikave të rendit të ditës, që mos t’ia marrim kohën as ministrit, pasi që ne jemi këtu dhe pas përfundimit të kësaj mbledhjeje, siç jeni të informuar nga administrata e komisionit, ne kemi një vizitë në KPMM, dhe besoj se dikush do të shmanget nga kjo dhe mund të mos ketë kuorum. Pyeti deputeten Mimoza Kusari-Lila, se a e keni marrë të gjithë dokumentacionin përkatës që e keni kërkuar dhe letrën e AKP-së? Më tutje, theksoi se unë nuk e kam marrë të AKP-së. Kryetarja pyeti edhe ministrin Hasani, nëse është i gatshëm të informojë lidhur me çështjen e ngritur: “Zgjedhja e sekretarit të ministrisë”, pasi që kjo çështje nuk është në rend dite.

Z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, tha se është i gatshëm të informojë për çështjen e zgjedhjes së sekretarit të përhershëm ministrisë”.

Mimoza Kusari-Lila, sqaroi se prej mbledhjes së kaluar kemi pranuar material nga Ministria e Pushtetit Lokal, ku është edhe vendimi i Kuvendit të Komunës për shpallje të interesit të veçantë, kështu që sipas saj, dosja është e kompletuar.

Pas diskutimeve, rendi i ditës, me shumicë votash, u miratua me propozimet e znj. Mimoza Kusari-Lila.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.01.2018

Kryetarja, theksoi se ka një plotësim në procesverbal, dhe për të mos humbur kohë, do t’ia dërgojë administratës së komisionit, që ta përfshijnë në procesverbal.

Procesverbali i mbledhjes së datës 30.1.2018, u miratua me plotësimin nga kryetarja.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr. 07/21, datë 22.12.2017, lidhur me ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067”

Kryetarja, pyeti se a ka dikush që të shtojë diçka në lidhje me këtë pikë, së paku për t’iu dhënë sqarim edhe mediave këtu, edhe shoqërisë civile që janë prezent për ecurinë procedurën se si ka ardhur deri te vendimi i Qeverisë, që këtë ndërmarrje shoqërore ta heqë nga AKP-ja, duke pezulluar edhe likuidimin që ka filluar nga AKP-ja, për ta shndërruar në ndërmarrje publike komunale. Do të doja të kërkoj edhe sqarimin se a ka marrë dikush nga deputetët informacion, se siç dihet Pallati i Rinisë është i ndërtuar nga kontributet e qytetarëve të komunave të rajonit, përfshirë Prishtinën, Obiliqin, Fushë-Kosovën, Lipjanin, Drenasin dhe Podujevën. A kemi ndonjë problem ligjor, në këtë drejtim, që një aset i ndërtuar me kontributet e këtyre qytetarëve

të vendoset të jetë si ndërmarrje publike e një komune? Mbi të gjitha, për mua është shumë e rëndësishme të di se a ka ndonjë plan financiar se si duhet të rregullohet apo vetëm të vendoset se është e kësaj komune dhe nuk dihet çka do të ndodhë me të, dhe a do të vazhdojë edhe me tutje degradimi i Pallatit të Rinisë, sikurse që është tani. Ju e dini, ndoshta ka qenë viti 2000, kur Pallati i Rinisë është dëmtuar nga një zjarr që ka kapluar dhe aty është dëmtuar edhe pasuria e disa pronarëve. A ka probleme kjo pronë me palë të tjera dhe borxhet që i ka, kush do t'i kryejë? Pra, këto janë dilemat e mia, theksoi kryetarja e komisionit.

Mimoza Kusari-Lila, sqaroi se lidhur me çështjet që i ngriti kryetarja, ajo që unë kam kërkuar, ka të bëjë kryesisht me procedurën që përfshin këtu Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, tash të gjitha këto janë të rregulluara. Mendimi i Qeverisë për shpallje të interesit të veçantë, i proceduar pranë komisionit tonë dhe tash rrjedhimisht votimi që do të procedohet në Kuvend, është ligj më vete, i cili rregullon të gjitha çështjet sa i përket çështjeve pronësore, derisa ligji për ndërmarrjet publike është ligj, i cili qartë e parasheh veprimtarinë e ndërmarrjeve publike komunale. Unë mendoj që pas sqarimeve që na janë dërguar, ta hedhim në votim dhe ta procedojmë tutje për shqyrtim në Kuvend, theksoi znj. Kusari-Lila.

Kryetarja, tha se janë ngritur shumë dilema rreth kësaj çështjeje. Përveç procedurave të kalimit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe një letër që ia kemi bashkëngjitur vendimit të Qeverisë nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, që ka kërkuar që hiqet nga procedura e likuidimit. Nuk e di a ka marrë dikush prej juve ndonjë dokumentacion se ku ka mbetur procesi i likuidimit, madje e kam parë që jam cituar keq nëpër media, sepse e di që pas vendimit të AKP-së, që Pallati i Rinisë të shkojë në likuidim, janë ndërtaur mekanizma që do të merren me procesin e likuidimit, d.m.th. në maj të vitit 2016, kur Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Kadastër, e ka marrë njoftimin se kjo ndërmarrje do të shkojë në likuidim, ndërkohë, atëherë Komuna e Prishtinës është kujtuar që t'ia bëjë një kërkesë edhe AKP-së, edhe Qeverisë që kjo ndërmarrje të mos shkojë në likuidim, por të shndërrohet në ndërmarrje publike. Unë e kam një informacion jo zyrtar, që ky proces ka shkuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe mos të keqkuptohemi nga mediat, sepse unë nuk e kam përcjellë në gjykatë këtë lëndë, por AKP-ja e ka dërguar lëndën në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Por, nuk e di çfarë vendimi dhe mendimi ka dhënë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në lidhje me Pallatin e Rinisë. Deputetët do të duhej ta kishin materialin. Absolutisht nuk jam për të penguar më tutje këtë aset që ti ipet kahje zhvillimit. Natyrisht, jemi për të respektuar vullnetin, jemi përcaktuar për demokraci dhe e vërteta vendoset me votë në demokraci, mirëpo nuk është mirë të këtë paqartësi deri në pafundësi, për askënd.

Bilall Sherifi, tha se tash jemi në procedurë, ku e kemi shteruar debatin dhe e tëra që kishte mbetur që të na sillen neve, kanë qenë dy letra që na kanë ardhur. Herën e kaluar, në komision nuk është hedhur në votim, në mungesë të këtyre dy dokumenteve, po të kishin qenë këto dyja, nuk do të bëhej sot ky debat. Sot jemi në procedurë për të votuar, sepse është kryer debati. Ta votojmë dhe ta kalojmë në seancë, le t'iu mbetet deputetëve dhe grupeve parlamentare të shprehin qëndrimet e tyre edhe deputetët veç e veç, edhe brenda partive mund të kenë pikëpamje të ndryshme, pastaj edhe komunat kanë në Kuvend deputetë të Drenasit, Fushë-Kosovës, të Lipjanit, le t'ia mbrojnë, mirëpo nuk është se këtu po vendoset sot edhe më nuk ka kthim mbrapa. Prandaj, që të mos humbim kohë, ta hedhim në votim, le të kalojë kjo çështje në

Kuvend, pastaj atje hapet debati ku i shfaqin edhe pikëpamjet politike, edhe ekonomike, si dhe të grupeve të interesit, siç janë në këtë rast komunat.

Kryetarja, theksoi se edhe unë jam për atë që ta përcjellim sot këtë vendim për seancë, me rekomandimin që ndërkohë, derisa të shkojë procedura në Kryesi e të vendoset për seancë, të plotësohen me dokumentacionin që u përmend, si planin financiar të komunës, një përgjigje nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, një letër nga AKP-ja, sesi ka vendosur ta përcjellë Qeverisë për shnëdrim në NP. Unë jam që me këto rekomandime ta përcjellim në seancë e pastaj atje vazhdojmë më tutje.

Hykmete Bajrami, theksoi që rekomandimet i kemi dhënë në mbledhjen e kaluar, kur kemi diskutuar për këtë pikë. Unë personalisht nuk kam kërkuar asnjë informacion dhe asnjë dokument shtesë, për shkak se i kam pasur informatat nga dora e parë. Në ndërkohë, që kur kemi diskutuar këtë pikë në mbledhjen e fundit, unë kam kontaktuar me kryetarin e Bordit të AKP-së dhe e ka konfirmuar se duhet të bëhet kalimi në komunë, d.m.th. nuk ka asnjë ndryshim të autoritetit të AKP-së rreth kësaj pike. Çështjet që ju i ngritët, dilemat se është ndërtuar me kontributin e qytetarëve të disa komunave, më së shumti me kontributin e qytetarëve të Prishtinës, kjo në fakt është forma, ajo do të mbetet ndërmarrje publike, në kuadër të komunës. Është shumë më mirë se ajo të privatizohet ose të likuidohet, ky është qëllimi i shumicës nga ne, nuk ka nevojë për plane financiare dhe gjëra të tjera, sepse këto janë sqaruar në Qeverinë e kaluar, janë sqaruar në Qeverinë e tashme, dhe krejt çka duhet të bëjmë, është t'ia përcjellim seancës edhe seanca të vendosë. Ne, javën e kaluar, kërkuam dokumentacion shtesë, erdhi dokumentacioni shtesë. Unë nuk e di pse këto që po i kërkonit sot, nuk i keni kërkuar javën e kaluar. Thjesht, po shihet si mungesë e vullnetit për ta përmbyllur një çështje dhe për t'ia dhënë një formë, sepse cilado formë tjetër, cilido status tjetër që e heq Pallatin e Rinisë nga status quaja, do të jetë më i mirë se ai i tanishmi. Unë po propozoj që ta vendosim në seancë, pa asnjë rekomandim dhe pa asnjë informatë shtesë, sepse tani i kemi të gjitha informatat shtesë dhe ta shterim këtë debat dhe të kalojmë në pikat tjera. Ju lutem vendoseni me votë, theksoi deputetja Bajrami.

Dardan Sejdiu, kërkoi që të vendoset me votë.

Kryetarja, tha se edhe unë po kërkoj të vendoset në votë, me rekomandimin që të kemi informacione shtesë dhe jam kundër që ta dërgojmë në seancë, pa rekomandime për informacione shtesë.

Pas diskutimeve, komisioni me 5 (pesë) vota “për” dhe 1 (një) votë “kundër”, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Të shqyrtohet Propozim-Vendimi i Qeverisë nr.07/21, datë 22.12.2017, për heqjen e Ndërmarrjes Shoqërore “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067” nga menaxhimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për autorizimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës, që Ndërmarrjen Shoqërore “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067” dhe asetet e saj, të regjistrohen si ndërmarrje publike lokale, pa rekomandime shtesë të komisionit.*

2. *Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

4. Informim nga z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me zgjedhjen e sekretarit të përhershëm të ministrisë

Kryetarja ia dha fjalën ministrit, që të informojë lidhur me zgjedhjen e sekretarit të përhershëm të ministrisë.

Z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, theksoi se ju si deputetë e dini si janë procedurat për zgjedhjen e sekretarit dhe kryeshefave dhe sqaroi se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë vetëm inicion procedurën për rekrutimin e sekretarit. Pra, kemi iniciuar konkursin, është kompetencë e Ministrisë së Administratës Publike (MAP), e cila udhëheq procedurat. Komisioni i intervistimit na ka dërguar tre emra, që ne t'i rekomandojmë një nga këta tre emra. Ne e kemi marrë parasysh renditjen dhe rekomandimin e komisionit edhe rekomandimin e kompanisë, të mbështetur nga Ambasada Britanike, që na ka ardhur edhe me shkrim, por është kompetencë e ministrit të vendosë brenda tre kandidatëve, se cili kandidat do të rekomandohet për votim. Ne kemi bërë propozimin e kandidatit Burim Rrecaj, e kemi kthyer në MAP dhe nga MAP-i është dërguar në Qeveri. E gjitha ka kaluar në procedurë të rregullt dhe është votuar në mënyrë unanime dhe nuk ka asnjë pengesë.

Mimoza Kusari-Lila, tha se është kompetencë e deputetëve të mbikëqyrë punën e ekzekutivit, gjithashtu është përgjegjësi e medimeve që ta përcjellin punën e institucioneve të vendit, sepse është një prej shtyllave të demokracisë, e nëse kjo iu pengon, atëherë keni problem me sistemin demokratik të vendit. Ajo tha se nuk po flas as me raportime mediale, as me tendenca politike, po flas me shqetësime të ngritura zyrtarisht nga një institucion i specializuar. Më tej, pyeti ministrin: a keni informacione se kandidati i përzgjedhur nuk ka qenë as në treshen e parë? Ka qenë kandidati i katërt sipas poentimit. Nga komisioni vlerësues dhe kompania është konstatuar se vetëm një kandidat i ka plotësuar kriteret, të tjerët nuk i kanë plotësuar. Qeveria e Republikës së Kosovës, me këto vendime është duke i rrezikuar 70 milionë euro nga Komisioni Evropian, për reformat në administratë, me vetëm kritikë të madhe politizimin e skajshëm të shërbimit civil.

Bilall Sherifi, theksoi se nga ministri dëgjuam aspektin formal si zgjidhet sekretari. Ndërsa, ajo çka tha kolegja, është informatë jo zyrtare. Kompania është njëri nga aktorët në procesin e përzgjedhjes, e ka dhënë mendimin e vet dhe kontributi i tyre nuk mund të shmanget. Nëse duhet gjithsesi të zgjidhet siç thotë kompania, atëherë t'ia lëmë tërë procesin kompanisë.

Mimoza Kusari-Lila, theksoi se vlerësimi i kompanisë dhe vlerësimi i komisionit profesional është i njëjtë. Nga katër të listuarit, kandidati i zgjedhur është i katërti në listë, vetëm një ka plotësuar kriteret.

Ministri, theksoi se e dimë rolin e kompanisë nga ambasada dhe është në rol vëzhgues. Neve na janë dërguar tre emra dhe unë kam rekomanduar njërin prej tyre. Ne mbajmë përgjegjësi për veprimet që ndërmarrim.

Hykmete Bajrami, theksoi se deputetët janë kontaktuar nga zyrtarë të Ambasadës së Britanisë së Madhe, dhe ajo që është ngritur si shqetësim, është shkelja e memorandumit. Janë edhe dy përzgjedhje që është anashkaluar kompania, zgjedhja e Bordit të Trepçës dhe Bordit të AKP-së. Kemi të bëjmë me shkeljen e një marrëveshjeje. Kandidati që është zgjedhur, është vlerësuar si i katërti. Vetëm një kandidat e ka plotësuar kushtin. Qeverisë i janë dërguar katër emra dhe u zgjedh i katërti. I mbetet komisionit që të kërkojë raportin zyrtar prej Ministrisë së Administratës Publike dhe ta përmyllim këtë çështje, dhe si shqetësim, duhet ta ngremë edhe në seancë plenare, para kryeministrit Haradinaj, sepse raportet me miqtë tanë ndërkombëtarë nuk është mirë të dëmtohen. Poenta është që procesi të jetë sa më transparent.

Kryetarja, theksoi se kjo çështje nuk është në domenin e komisionit dhe komisioni nuk është përgjegjës të kërkojë raport për këtë çështje.

Memli Krasniqi, theksoi se që të tre, duke aluduar edhe në deputeten Bajrami dhe Kusari-Lila, kemi qenë ministra dhe sekretarin e ka zgjedhur kënd ka dashur ministri. Më së miri do të ishte të ndryshohet legjislacioni që do të lejonte ministrin ta zgjedhë vetë sekretarin. Ministrinë dhe Qeveria e kanë përmbushur procesin ligjor në përzgjedhje. Monitorimi është nënshkruar nga Qeveria e mëparshme edhe e tashmja dhe janë si vëzhgues. Kjo çështje nuk është kompetencë e komisionit. Ai theksoi se çështjen e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, jemi duke e shtyrë pa nevojë, e kemi të bllokuar një institucion tepër të rëndësishëm dhe një obligim tonin nuk jemi në gjendje ta përmbushim. Ju e keni marrë prej ambasadorit britanik, një letër, duke u bazuar në vlerësimin e kompanisë dhe ka thënë se vetëm këta dy të parët, në listën e kandidatëve të Bordit të ZRRE-së, i përmbushin kushtet dhe kërkoi që, në të ndryshme, të futet Bordi i ZRRE-së edhe një herë për shqyrtim.

Dardan Sejdiu, potencoi dy çështje: e para, pse nënshkruhen marrëveshje dhe nuk zbatohen? Dhe e dyta, lidhur me Bordin e ZRRE-së i kam shkruar email ministrit Lluka, më është përgjigjur dhe është në rregull, sa më përket mua, të procedohet më tutje.

Ministri, përsëriti se si ministri jemi në rregull dhe ndoshta zgjedhja e personit të përfolur do t'ia prishë çerdhen dikujt nga ish-ministret dhe tani po kemi këto reagime të pabaza.

Mimoza Kusari-Lila, kërkoi sqarime nga ministri se për çka e ka fjalën, kur i referohet ish-ministreve, me akuza të pabaza.

Kryetarja ndërpreu debatin, duke konsideruar se është shterur debati dhe është duke u diskutuar jashtë rendit të ditës.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të kërkojë nga ministri, informata shtesë lidhur me çështjet e ngritura, në bazë të kompetencave të komisionit, sa herë që kjo të kërkohet nga deputetët.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit

Kryetarja, tha se është ministri këtu për të prezantuar projektligjet dhe ia dha fjalën, që të bëjë prezantimin e projektligjit për produkte të ndërtimit.

Ministri, theksoi se arsye për hartimin e projektligjit për produkte të ndërtimit, është rregullimi i kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-së. Ligji aktual ka disa paqartësi dhe mangësi, të cilat në detaje janë përshkruar në koncept dokument, ku si rezultat i tyre, janë shfaqur pengesa në implementim të ligjit. Qëllimi i projektligjit është krijimi i një baze të përshtatshme legjislative, mbi të cilën do të bëhet i njohur sistemi i vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshëm të performancës së produkteve të ndërtimit. Arsye tjetër e hartimit të këtij projektligji, është harmonizimi me MSA-në. Janë gjithsej shtatë kërkesa themelore për produkte të ndërtimit, si: rezistenca mekanike dhe qëndrueshmëria, siguria në rast zjarri, higjiena, shëndeti dhe mjedisi, siguria në përdorim, mbrojtja nga zhurma, eficientia e energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore. Në fund, ministri siguroi që projektligji për produktet e ndërtimit është hartuar në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, dhe miratimi i këtij projektligji është i rëndësishëm për ngritjen dhe zhvillimin e fushës së produkteve të ndërtimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të tregut të prodhueseve në Republikën e Kosovës, si dhe propozoi që të shqyrtohet dhe miratohet ky projektligj dhe të procedohet më tutje në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Mimoza Kusari – Lila, në shenjë proteste lidhur me deklaratën e ministrit, në pikën që u diskutua për zgjedhjen e sekretarit të përhershëm, lëshoi mbledhjen.

Bilall Sherifi, tërhoqi vërejtjen ministrit dhe tha se jo vetëm ky ministër, por të gjithë ministrat duhet të kenë sjellje korrekte, kur janë në komision, respektivisht në Kuvend.

Në mungesë të kuorumit, kryetarja ndërpreu mbledhjen.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, më 14.2.2017, në orën 12:00, salla C-203, ndërtesa e Kuvendit.

Pjesëmarrës nga komisioni: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetarë i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Kryetarja, theksoi se po e vazhdojmë mbledhjen e ndërprerë më 7.2.2018, për shkak të mungesës së kuorumit. Kjo mbledhje u ndërpre pas prezantimit të ministrit për projektligjin për produkte të ndërtimit. Prandaj, meqenëse është shqyrtim në parim, ta votojmë në parim këtë projektligj dhe ta procedojmë për seancë plenare.

Dardan Sejdiu, tha se do të duhej të ishte dikush nga ministria të bëjë prezantimin e projektligjeve dhe gjithashtu kemi Projektligjin për masat mbrojtëse në importe, që kemi kërkuar të vijë në pako me projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, dhe Projektligjin për tregtinë e brendshme. Unë do ta përkrah Projektligjin për produkte të ndërtimit, sepse ai është prezantuar, por jo dy projektligjet tjera.

Hykmete Bajrami, po ashtu potencoi se dikush nga ministria do të duhej të merrte pjesë, sepse për shembull kam pyetje për projektligjin për produkte të ndërtimit, dhe për shkak të mos-prezencës së tyre, nuk mund të sqarohet. Ajo kërkoi që mos të kthehet projektligji për masat mbrojtëse në importe, por duhet kërkuar, për të përshpejtuar që dy projektligjet tjera të vijnë në Kuvend dhe të shqyrtohen në pako.

Memli Krasniqi, gjithashtu theksoi se duhet të ishte dikush nga ministria. Pyetjet që mund t'i bëjmë do të duhej të sqaroheshin nga ministria. Këto projektligje shkojnë në lexim të parë dhe unë jam që këto dy projektligje të shkojnë për në seancë, ndërsa projektligji për masat mbrojtëse në importe, të mos trajtohet derisa të vijnë projektligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe projektligji për tregtinë e brendshme.

Kryetarja, tha se nuk është korrekte që mos të jetë dikush nga ministria. Sa i përket pikave të rendit ditës, në parim t'i hedhim në votim, një nga një, dhe ne kemi kohë që mes dy leximeve t'i trajtojmë projektligjet dhe t'i konsultojmë palët e interesit, prandaj mos të humbim kohë.

Pas debatit, komisioni, me 4 (katër) vota "për", 2 (dy) "kundër" dhe 1 (një) "abstenim", nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit.*

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit

Dardan Sejdiu, theksoi se është i interesuar që edhe projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, ta trajtojmë në kuadër të pakos së projektligjeve që po ndërlidhen me prodhimin vendor dhe masat për mbrojtjen e prodhimit vendor.

Memli Krasniqi, potencoi se projektligji për masat mbrojtëse në importe, projektligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe projektligji për tregtinë e brendshme, shkojnë bashkë, ndërsa projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit ta përcjellim në këtë formë, mandej do të na kthehet neve për shqyrtim.

Kryetarja, sqaroi se me ndryshimin e Rregullores së Kuvendit, është vendosur se mund të ftohet ministri gjatë shqyrtimit në parim në komision, por më herët, në legjislaturat e kaluara, nuk janë ftuar ministritë gjatë shqyrtimit në parim. Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit

ta përcjellim në lexim të parë. Madje, kam menduar që projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit ta marrim për monitorim të zbatimit, sepse është një ligj i rëndësishëm.

Bilall Sherifi, theksoi se sapa ka komunikuar me kabinetin e ministrit dhe ata nuk kanë informacione që duhet të jenë sot në mbledhje të komisionit. Pra, nuk është mungesë e gatishmërisë së tyre. Ai kërkoi sqarim nga kryetarja, pse nuk janë ftuar, sepse u bë shumë debat për mungesën e tyre, ndërsa ata nuk kanë pasur informacione.

Kryetarja, sqaroi se mbledhjen e kaluar u fol në mbledhje se ministrat, ndoshta nuk kanë nevojë të prezantojnë projektligjin në parim, ndërsa departamenti ligjor ka qenë i njoftuar, por në moment të fundit kanë njoftuar se nuk mund të marrin pjesë.

Pas debatit, komisioni, me 5 (pesë) vota “për”, 2 (dy) “kundër” dhe 2 (dy) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit.*

7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe

Kryetarja, pra ashtu siç u diskutua edhe në pikat tjera, por edhe në plan të punës së komisionit, ky projektligj duhet të trajtohet në pako projektligjesh.

Pas debatit, komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Konkluzion

- 1. Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.*
- 2. T'i dërgohet shkresë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që ta procedojë në Kuvend edhe projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe projektligjin për tregtinë e brendshme, që të shqyrtohen në një pako, me projektligjin për masat mbrojtëse në importe.*

8. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA